



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËS, ÇËSHTJEVE SOCIALE
DHE SHANSEVE TË BARABARTA

Plani i Integruar i Ministrisë

2008

Shkurt 2008

Mesazhi i Ministrit



Programi i Qeverisë në fushën e politikave të punësimit, shërbimeve sociale dhe migracionit, nëpërmjet krijimit dhe garantimit të shanseve të barabarta për të gjithë shtetasit, është konkretizuar në objektivat e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) dhe insitucioneve e agjensive të sistemit të saj.

Në qendër të këtyre objektivave qëndron zhvillimi i politikave për nxitjen e përfshirjes sociale, rritjen e punësimit, uljen e papunësisë dhe zbutjen e varfërisë.

Institucionalizimi i mëtejshëm i dialogut e partneritetit social si edhe rritja e performancës së strukturave dhe insitucioneve të Ministrisë do të ndikojë pozitivisht në forcimin e kohezionit social, reformimin dhe modernizimin e politikave sociale dhe konsolidimin e tipologjive të reja të shërbimeve sociale.

Një nga elementët më të rëndësishëm të reformës që Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta ka ndërmarrë në fushën e shërbimeve sociale është mbulimi më i mirë i territorit të vendit me shërbime, monitorimi i cilësisë së shërbimeve, përmirësimi i cilësisë së shërbimeve përmes licensimit të ofruesve, rritjes së performancës së inspektimit dhe zbatimit të standardeve të shërbimeve nga ofruesit publik, privat apo jofitimprurës.

Plotësimi i kuadrit ligjor dhe institucional në fushën e politikave të punësimit, shërbimeve sociale dhe migracionit është një mbështetje e sigurtë për përsosjen dhe modernizimin e të gjithë sistemit dhe do të kontribuojë në thellimin e luftës kundër informalitetit në tregun e punës, në menaxhimin më të mirë të migracionit dhe përgjigjet adeguate ndaj nevojave të popullsisë me shërbime.

Zhvillimi i politikave migratore nuk mund të konsiderohet thjesht një shumatore matricash, aktesh ligjore, masash apo planesh veprimi, por produkt i negociatave me vendet pritëse të emigrantëve, të kombinuara me politikat komunitare dhe globale. Në perspektivën e Qeverisë, emigrantët janë kontribues të zhvillimit në vendet dërguese e pritëse, ura komunikimi dhe “agjentë” të globalizimit, prandaj çështjet e emigracionit do të vazhdojnë të trajtohen në këtë perspektive, duke e konsideruar komunitetin e emigrantëve shqiptarë një pararendës të integritit dhe të ardhurat nga emigracioni një burim të rëndësishëm zhvillimi.

Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, duke u bazuar në një nga prioritet kryesorë të Programit të Qeverisë, qeverisjen “me duar të pastra”, ka vendosur në qendër të punës së vet rritjen e forcës zbuluese, monitoruese, kontrolluese dhe zbatuese të organeve të auditit, inspektimit dhe kontrollit; rritjen e transparencës, eficiencës dhe efektivitetit në përdorimin e financave publike dhe luftën kundër korrupsionit, parandalimin e konfliktit të interesave në administratën, insitucionet, agjensitë dhe shërbimet e sistemit, duke synuar performancë, përgjegjshmëri dhe transparencë në të gjithë sportelet e shërbimeve.

Realizimi i këtyre objektivave nga ana e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, do të ndikojë në përmirësimin e cilësisë së jetës së qytetarëve si dhe do të rrisë performancën e institucioneve e agjensive të saj dhe kontributin e tyre në jetën ekonomike e sociale të vendit.

Koço Barka

Minister i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta

Pasqyra e lëndës

1	Misioni i Ministrisë	5
2	Dokumenta strategjike të Ministrisë	6
3	Programet buxhetore të Ministrisë	7
4	Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008.....	8
5	Plani i Monitorimit të Ministrisë	13
Aneks 1	Projekt-ligjet për tu paraqitur.....	14
Aneks 2	Rezultate që lidhen me Integrimin European	15
Aneks 3	Investimet publike	16
Aneks 4	Projekte të ndihmës së huaj	17
Aneks 5	Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit	18

1 Misioni i Ministrisë

Misioni i Ministrisë se Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta është zbatimi i politikave të Qeverisë për rritjen e standarteve të jetesës së shqiptarëve nëpërmjet masave që synojnë:

- Kontributin në mbështetjen e stabilitetit të fuqisë punëtore, duke rritur produktivitetin e punonjësve, sigurimin e shpërblimit të drejtë dhe përfitimit nga puna, dhe duke promovuar sigurinë e shoqërisë si domosdoshmëri për zhvillimin e përgjithshëm social ekonomik.
- Kontributin në zhvillimin e burimeve kombëtare njerëzore duke forcuar sektorin e trainimit me qëllim ngritjen e kompetencave të përgjithshme të fuqisë punëtore, përmirësimin e konkurrencës së vendit nëpërmjet zotërimit të një fuqie punëtore efiçente, dhe konsolidimin e pozitës së vendit si një qendër rajonale për trainimin dhe zhvillimin e burimeve njerezore.
- Kontributin në përmirësimin e shërbimeve sociale për familjet në nevojë, të paaftët, dhe të moshuarit, gjithashtu zhvillimin e rolit të gruas, Shoqatave dhe organizatave të tjera sociale.

2 Dokumenta strategjike të Ministrisë

Strategjia sektoriale e punësimit dhe formimit profesional

Strategjia Sektoriale e Punësimit dhe Formimit Profesional ka përfunduar dhe është miratuar nga ana e Këshillit të Ministrave me VKM Nr. 751, datë 07.11.2007. Në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit ka filluar puna për zbatimin e saj. Aktualisht për vitin 2008, bazuar në Planin e veprimeve për zbatimin e Strategjisë, janë hartuar treguesit e monitorueshëm, të cilët janë specifikuar për zyrat rajonale dhe vendore të punësimit si dhe drejtoritë rajonale të formimit profesional publik.

Strategjia sektoriale e mbrojtjes sociale

Strategjia Sektoriale e Mbrojtjes Sociale, miratuar me VKM Nr. 80 date 28.01.2008 është një dokument politik në të cilin pasqyrohet reformimi i sistemit të pagesave dhe shërbimeve shoqërore.

Reformimi i skemës së ndihmës ekonomike dhe pagesave të tjera, do të mbështetet në identifikimin e nevojave të familjeve të varfëra mbi bazën e treguesve të varfërisë absolute, mbulimin më të mirë të nevojave me fonde dhe sigurimin e një niveli dinjitoz jetese për familjet, PAK dhe përfitues të tjere të programeve sociale. Në fushën e shërbimeve shoqërore, reforma ka në themel të saj ngritjen e shërbimeve në nivel komunitar, atje ku janë përfituesit dhe lindin nevojat e tyre, për të mbështetur dhe ndihmuar individët, familjet, grupimet dhe komunitetet të vet-funksionojnë, të jenë të pavarur dhe të përfshihen si të barabartë në zhvillimet shoqërore.

Strategjia ndërsektoriale e përfshirjes sociale

Strategjia Ndërsektoriale e Përfshirjes Sociale u miratua nga Këshilli i Ministrave me VKM Nr.218 datë 3.02.2008. Aktualisht po punohet për fuqizimin e strukturave monitoruese dhe përcaktimin e pikave koordinuese me të gjitha ministritë e linjës për monitorimin e zbatimit të strategjisë.

Strategjia ndërsektoriale e migracionit

Në zbatim të vendimeve të Komitetit Ndërministror të Migracionit, Qeveria Shqiptare mori përsipër të rishikoj Planin Kombëtar të Veprimit të Strategjisë së Migracionit në përshtatje me prioritetet e Programit të Qeverisë në kuadrin e rishikimit të Planit Kombëtar të Përafrimit të Legjislacionit.

Aktualisht po punohet për ngritjen dhe funksionimin e kuadrit ndërministror të migracionit, i cili do të përmirsojë menaxhimin e migracionit nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të politikave të reja migratore në zbatim të kësaj strategjie, zbatimin e Planit të Veprimit për Remitancat e Migracionit, hartimi i strategjisë së informimit dhe komunikimit për çështjet e migracionit, forcimin e lidhjeve e bashkëpunimit me komunitetin e emigrantëve shqipëtarë, nxitjen e kthimit vullnetar të emigrantëve të suksesshëm ose kapitaleve të tyre, si burim për zhvillimin e vendit, ndjekjen e dinamikave të zhvillimeve të politikave e legjislacionit migrator në vëndet pritëse, për lehtësimin e integritimit të emigrantëve në tregun e punës.

Strategjia ndërsektoriale e barazisë gjinore dhe parandalimit të dhunës në familje

Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore dhe parandalimin e Dhunes ne Familje u miratua me VKM Nr.913 , datë 19.12.2007. Ka filluar zbatimi i Planit të Veprimit të Strategjisë, i cili përmban 8 prioritetet strategjike dhe mbështetet nga Programi ONE -

UN, si dhe donatorë të tjerë të cilët kanë në objekt të punës së tyre çështjet e barazisë gjinore dhe luftën kundër dhunës në familje.

Aktualisht është krijuar struktura për masat kundër dhunës në familje me Urdhër Nr. 202, datë 5.12.2007, veprimtaria e së cilës do të fokusohet në zbatimin e Ligjit Nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” dhe SKBGJ/DHF.

Qëllimet

Politika e këtij sektori është hartuar për të kontribuar në arritjen e qëllimeve të më poshtme afatgjata:

- MPÇSSHB do të organizohet dhe strukturohet në mënyre të tillë që të jetë e aftë të realizojë me efikasitet obligimet dhe programet e qeverisë shqiptare, ashtu si ato janë përshkruar në programin qeveritar dhe në nivelin ndërkombëtar, në mënyre që Shqipëria të përmbushë kërkesat PVEP dhe marrëveshjet e tjera ndërkombëtare në të cilat qeveria shqiptare është palë.
- Të arrihet brenda 4 viteve rritja me 50% e pensioneve mesatare të vitit 2005 si dhe të arrihet që në fund të vitit 2012 pensionet e personave të vetëpunësuar në bujqësi të jenë të barabarta me ato të personave të punësuar në sektore të tjerë. Të minimizojmë efektet negative të rritjes së cmimeve në standartin e jetesës së pensionistëve si dhe të mundësojnë shpërblime për persona të caktuar që përfitojnë nga statuset e caktuara. Nëpërmjet indeksimit të arrihet të ruhet vlera reale e përfitimeve si dhe një rritje reale e mundshme e tyre
- Reduktimi i varfërisë dhe rritja e cilësisë së shërbimeve të kujdesit social.
- Nxitja dhe mbështetja e shërbimeve të përsosimit të plotë, produktiv dhe të zgjedhur lirisht dhe të përmbushet e drejta e shtetasve për punësim fitimprures, për këshillim dhe kualifikim profesional dhe sigurohet mbështetja me të ardhura. Qëllimi final ulja e nivelit të papunësisë në nivelin e vendeve të BE deri në momentin e anëtarësimit. Formimi profesional siguron rritjen e aftësive profesionale të personave punëkërkuar të papunë të regjistruar në Zyrat e Punësimit në ato profesione që kërkohen nga tregu i punës, sipas Strategjisë së Arsimit dhe Formimit Profesional. Qëllimi i investimeve për QFP Publike është rritja dhe shtrirja në aspektin gjeografik të qendrave publike të formimit profesional; rritja e efektivitetit të QFP Publike nëpërmjet paisjeve me kabinete të reja; përmirësimi i cilësisë së formimit profesional nëpërmjet përmirësimit dhe zhvillimit të kurrikulave, hartimit dhe vendosjes së standarteve të kualifikimeve profesionale, trajnimit të trajnerëve etj.
- Inspektimi në punë, i përballur me formulimin e një vizioni të ri, për të orientuar shërbimin e tij drejt një qëllimi të ri, duke zhvilluar politika të reja aktive, strategji dhe masa parandaluese për uljen e aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale, do të mundësojë krijimin e kushteve të punës, sipas standarteve ndërkombëtare, me qëllim që jeta mesatare e punëmarrësve të jetë e barabarte me atë të komunitetit.
- Forcimi i mekanizmave ligjorë dhe institucionalë mbrojtës për sigurimin e barazisë gjinore në Shqipëri, fuqizimi i gruas nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së saj në vendimmarrje, rritja e ndërgjegjësimit ndaj dukurisë së dhunës, mbrojtja ligjore dhe administrative si dhe mbështetja për individë të prekur nga dhuna në familje.

3 Programet buxhetore të Ministrisë

3.1 PLANIFIKIM, MENAXHIM, ADMINISTRIM

Politika e këtij programi synon të mbështesë arritjet efektive të qëllimeve dhe objektivave të MPÇSSH si dhe të ndihmojë e të mbështesë qeverisjen duke rritur eficientë e burimeve njerëzore, materiale dhe financiare.

3.2 SIGURIMI SHOQËROR

Politika e këtij programi konsiston në mbrojtjen më të ardhura për personat në lidhje me humbjen e aftësisë për punë për shkak të sëmundjes, barrë lindjes, pleqërisë, invaliditetit, humbjen e mbajtësit të familjes, aksidentin në punë, sëmundjes profesionale dhe papunësisë si edhe rritjen e vazhdueshme të përfitimeve nga pensionet dhe rritjen e pensioneve të fshatit me ritme më të larta se ato të qytetit deri në barazimin e tyre. Gjithashtu, synon dhe përmirësimin e skemës ekzistuese me skema të tjera suplementare.

3.3 MBROJTJA SOCIALE

Politika e këtij programi konsiston në zbutjen e varfërisë dhe përfshirjen e familjeve dhe individëve në shërbime sociale, pagesa të menjëhershme dhe shërbime të kombinuara për përmirësimin e jetës së tyre.

3.4 TREGU I PUNËS

Politika e këtij programi synon të rrisë punësimin e ligjshëm brenda dhe jashtë vendit dhe të reduktojë migrimin ilegal dhe punësimin në ekonomine informale. Të kontribuojë në shmangien e varfërisë për shkak të pagave të ulta dhe papunësisë duke vendosur një page minimale të arsyeshme dhe duke paguar pagesën e papunësisë për ata që kanë akoma të pamundur të gjejnë punë. Të zhvillojë politika aktive të tregut të punës për të papunët në përputhje me udhëzimet e punësimit të BE-së.

3.5 INSPEKTIMI NË PUNË

Politika e këtij programi synon arritjen e standarteve ndërkombëtare të sigurisë dhe shëndetit në punë të punëmarrësve.

3.6 SHANSET E BARABARTA

Politika e këtij programi konsiston në formulimin dhe zhvillimin e politikave për nxitjen e barazisë në fusha të tilla si: barazia gjinore, pabarazia në aftësi, pabarazia moshore, ajo brezoze dhe racore dhe monitorimi i Strategjive të PAK dhe Fëmijëve.

4 Përmbledhje e angazhimeve kryesore në 2008

Sipas programeve, Ministria do të ofrojë produktet e mëposhtme në 2008.

4.1 PLANIFIKIMI, MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivat e politikës

- Manaxhimi efikas i burimeve financiare dhe materiale të aparatit të MPÇSSH
- Përmirësimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe rritja e efikasitetit të sistemit të IT
- Përfundimi i marrëveshjeve për barazinë gjinore, identifikimi i projekteve në fushën sociale
- Krijimi i standarteve për kuadrin ligjor, marrëveshjeve dhe projekt-propozimeve
- Përmirësimi i shërbimit statistikor.

Produktet që do të ofrohen

- 350 Raporte financiare.
- Përputhshmëria e 45 akteve ligjore me standartet ndërkombëtare.
- 290 Rekrutime të reja, trajnime dhe vlerësime të stafit.
- 60 Raporte auditimi.
- Manaxhimi i 300 dokumentave dhe arkivimi.
- 200 Raporte buxhetore e financiare.
- Raport progresi i strategjisë së Përfshirjes Sociale matrica e indikatorëve ISM.
- 2 buletine statistikore

4.2 SIGURIMI SHOQËROR

Objektivat e politikës

- Rritja e pensioneve të qytetit 9%, rritja e pensioneve të fshatit 15% duke filluar nga 1 korriku 2008.

Produktet që do të ofrohen

- Transferta në buxhetet familjare nga sigurimi shoqëror i detyrueshëm për 525 mijë pensionistë, kryerja e pagesave për 291 mijë ditë paaftësie, për 10 mijë gra për barrë lindje, për 18 mijë ditë paaftësie nga aksidentet.
- Transferta në buxhetet familjare i fondeve të vëna në dispozicion nga buxheti për kompensimin e cmimit të energjisë për 525 mijë persona , për 104 mijë persona në varësi të përfituesve, për 364 mijë persona që kompensohen për bukën, për 18200 veteranë të luftes, për 8900 invalidë të punës .
- Transferta të realizuara në buxhetet familjare nga fondet e sigurimeve suplementare për 1020 punonjësit e lartë të shtetit, për 3200 ushtarake të SHIK e rendit, pagesa për 1100 familje të deshmorëve të atdheut, e trajtimet e vecanta për 4700 minorë, për 880 ish punonjës të industrise ushtarake dhe 430 punonjësve të policië.

4.3 MBROJTJA SOCIALE

Objektivat e politikës

- Përmirësimi i sistemit të targetimit të familjeve të varfëra, zgjerimi i grupeve në nevojë në skemën e NE dhe përjashtimi i rasteve abuzive.
- Rritja e pagesave për PAK sipas pagës minimale.
- Garantimi i cilësisë së shërbimeve të përkujdesit shoqëror.
- Rritja e buxhetit për programin e ndihmës ekonomike.

Produktet që do të ofrohen

- Ofrimi i Shërbimeve të decentralizuara për 600 klientë.
- Shërbime Rezidenciale së bashku me qendrën për të Verbërit për 230 kliente.
- Kompesimi i 110 mijë familjeve të varfëra nga rritja e çmimit të energjisë elektrike.
- Lëshimi i 50 Licensave.
- 12 Raporte inspektimi mbi standartet e shërbimeve shoqërore.
- 18 raporte inspektimi mbi zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe pagesave të PAK.

4.4 TREGU I PUNËS

Objektivat e politikës

- Rritja e punësimit brenda dhe jashtë vendit nëpërmjet ndërmjetësimit, orientimit, këshillimit për punë dhe profesion dhe formimit profesional duke marrë masat e përputhjes së atyre që kërkojnë punë me ata që ofrojnë punë.
- Ulja e nivelit të papunësisë me 0.3% në vit.
- Forcimi i dialogut social ndërmjet punëdhënësve dhe punëmarrësve dhe institucionalizimi i marrëdhënieve ndërmjet tyre.

Produktet që do të ofrohen

- 2000 -2500 të punësuar nëpërmjet programeve të nxitjes së punësimit.
- 7000 të trajnuar dhe çertifikuar.
- 11,000 Persona të trajtuar me pagesë papunësie.
- Ofrimi i ndërmjetësimit dhe këshillimit për tregun e punës për 10.500 persona.

4.5 INSPEKTIMI NË PUNË

Objektivat e politikës

- Përmirësimi dhe harmonizimi i legjislacionit shqiptar të punës në përputhje me atë të BE, në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë.
- Rritja e efektivitetit të inspektimeve, duke siguruar zbatueshmërinë e kuadrit ligjor të punës në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, me qëllim uljen e aksidenteve në punë.
- Bashkëpunimi me Organet Tatimore duke raportuar të gjitha subjektet që konstatojnë gjatë inspektimit inspektorët e punës që ushtrojnë aktivitet informal si

dhe subjektet që kanë të punësuar informal, për tu rregjistruar nga organet tatimore, me qëllim reduktimin e ekonomisë dhe punës informale.

Produktet që do të ofrohen

- 4 akte ligjore dhe nënligjore të përafuara.
- Inspektime dhe kontrole administrative në të gjitha aktivitetet e ndërtimit.
- Ushtrimi i 7000 inspektimeve dhe kontrolleve administrative nëpër sektorë të ndryshëm të ekonomisë
- 2 kontrole të përbashkëta me Dejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve në 4000 subjekte.
- 4 Fushata sensibilizuese.

4.6 SHANSET E BARABARTA

Objektivat e politikës

- Përmirësimi i kuadrit ligjor, dhe ngritja e kapaciteteve institucionale për arritjen e barazisë gjinore dhe dhunen në familje.
- Rritja e numrit të grave në vendimmarrjen politike.
- Ndërgjegjësimi i opinionit publik, sidomos i grave dhe vajzave të reja, lidhur me të drejtat ligjore që atyre iu takojnë.
- Fuqizimi dhe ngritja e kapaciteteve të rrjetit të pikave të kontaktit në nivel lokal dhe qendror.
- Ngritja e njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor.
- Përmirësimi i politikave dhe programeve për punësimin e PAK.
- Sigurimi i barazisë për të gjithë të drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar.

Produktet që do të ofrohen

- Miratimi i Ligjit “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” dhe akteve nënligjore të këtij ligji.
- Organizim i një Fushate sensibilizuese “Të Drejtat e Grave dhe Vajzave janë të Drejtat e Njeriut”
- Futja e kuotës për gjininë më pak të përfaqësuar në nivel legjislativ, ekzekutiv dhe në poste publike.
- Hartimi i akteve nënligjore për dhunën
- Krijimi i modelit të njësive për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel qarku dhe nivel bashkie. Ngritja e 2 njësive të reja për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor.
- Trainimi i strukturave të reja dhe atyre ekzistuese për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në nivel vendor.
- Raportet 6-mujore dhe 1-vjeçare për zbatimin e Strategjisë së Fëmijëve
- Fushatë sensibilizuese në media mbi njësitet për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.
- Hartimi i një ligji Integral për PAK.

- Përgatitja e programeve të punës dhe trajnimit të përfaqësuesve të rrjetit të pikave të kontaktit PAK.
- Përgatitja e Progres Raportit për vitin 2008 , për Strategjinë e PAK.

Tabela Buxheti 2007 sipas programeve dhe llojeve të shpenzimeve, million Lek

Programet	Pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore 600, 601	Mallra dhe shërbime 602	Subveconet 603	Të tjera transferta korrente 604, 605	Transferta për buxhetet familiare dhe individët 606	Shpenzim e kapitale 230, 231	Total
Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi	106	50	0	5	0	33	194
Sigurimi Shoqëror	5	0	0	14,925	0	0	14,931
Mbrojtja Sociale	411	213	0	25	14,442	276	15,367
Tregu i Punës	309	100	200	0	1,000	186	1,795
Inspektimi në Punë	137	20	0	0	0	0	157
Shanset e Barabarta	9	2	0	0	0	0	11
Total	977	385	200	14,955	15,442	495	32,455

5 Plani i Monitorimit të Ministrisë

Identifikoni dhjetë produktet/treguesit më të rëndësishëm që do të monitorojnë arritjet e ministrisë gjatë vitit 2008.

Treguesit	Njësia	Qëllimi
1. Rritja e masës mesatare të NE/familje	përqindje	35(krahasuar me 2007)
2. Rritja e masës së pagesës për PAK	“	6,2 (krahasuar me 2007)
3. Ulja e nivelit të papunësisë	“	0,3 (krahasuar me 2007)
4. Numri i personave të kualifikuar në Qendrat e Formimit Profesional	Numër fizik	7000
5. Numri i të punësuarve në programet e nxitjes së punësimit	“	2000-2200
6. Numri i të trajnuarve për barazinë gjinore ne strukturat qendrore dhe vendore	“	100
7. Numri i akteve ligjore dhe nënligjore të miratuara te fushave që mbulon Ministria	“	22
8. Rritja e numrit të kontratave kolektive të punës	përqindje	10 (krahasuar me 2007)

Aneks 1 Projekt-ligjet për tu paraqitur

PROJEKTLIGJE

- “Për të huajt”
- “Për një ndryshim në ligjin nr 9355, datë 10.03. 2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore“
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.8872, date 29.03.2002, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”
- “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”
- “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”

PROJEKTVENDIME

- “Për caktimin e nivelit bazë të pagesës së papunësisë“.
- “Për ngritjen dhe funksionimin e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore”
- “Për një ndryshim në VKM nr 787, datë 14.12.2005 “Për përcaktimin e kritereve të procedurave dhe të masës së ndihmës ekonomike “
- “Për masën e indeksimit të pagave“
- “Për një ndryshim në VKM nr 512, datë 31.05. 2006,“Për procedurat e kontrollit të ndihmës ekonomike të pagesës së aftësisë së kufizuar dhe shërbimeve shoqërore“
- “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 42, datë 17.01.1998, të Këshillit të Ministrave,“Për miratimin e statutit të Shërbimit Kombëtar të Punësimit”, të ndryshuar “.
- “ Për marrëveshjet e mirëkuptimit me institucionet që mbulojnë çështjet migratore në Itali dhe Greqi “
- “Për pagën minimale në shkallë vendi “
- “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë “
- “Për tarifatat e lejes së punës për shtetasit e huaj“
- “Për dokumentacionin dhe masën e financimit të familjes kujdestare“
- “Për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Këshillit Kombëtar të AFP-së ”
- “Për modalitetet e kryerjes së praktikave profesionale në ndërmarje nga nxënësit dhe kursantët e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional dhe teknik, si edhe llojet e mbështetjes shtetërore“
- “Për përcaktimin e procedurave të konkurimit të institucioneve publike apo private, ofrues të formimit profesional, që financohen nga zyrat e punësimit”
- “Për përcaktimin e masave dhe strukturat përkatëse për nxitjen dhe mbështetjen e reintegrimit të emigrantëve në jetën ekonomike, sociale dhe politike të vendit, nëpërmjet krijimit të lehtësive fiskale dhe zbatimit të programeve të zhvillimit të biznesit, të punësimit dhe të formimit profesional nëpërmjet punës”.
- “Për mënyrën e funksionimit dhe varësinë e inkubatorëve të biznesit”

Aneks 2 Rezultate që lidhen me Integrimin Europian

- Krijimi i strukturave konsultative me pjesëmarrjen e pushtetit vendor, shoqërisë civile, organizatave të pundhënësve dhe sindikatat në 12 prefektura për të konsultuar problematikat social-ekonomike njohjen e legjislacionit të punës.
- Institucionalizimi i metodologjisë së hartimit të kurrikulave të AFP-së.
- Kompletimi i procesit të informatizimit të tregut të punës në gjithë sistemin e shërbimit publik të punësimit duke shfrytëzuar investimet e donatorëve.
- Fushatë sensibilizuese mbi njohjen dhe vënien në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Barazi Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje.
- Monitorimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Kundër Dhunës në Familje.
- Ndryshime në Nenin 104 të Kodit të Punës të RSH.
- Projekt VKM “Për nxitjen e kthimit vullnetar të emigranteve shqiptare dhe riintegrimin të tyre”.
- Negocimi dhe nënshkrimi i Marrëveshjeve të Mirëkuptimit me institucionet që mbulojnë çështjet migratore në Itali dhe Greqi.
- Takim ndërkombëtar me institucionet homologe të vendeve të rajonit për minoritetet në lidhje me legjislacioni për minoritetet në rajonin e Ballkanit.
- Projekt VKM i strategjisë kombëtare të sigurise dhe shëndetit në punë.
- Nënshkrimi dhe ratifikimi i marrëveshjeve me Italinë dhe Greqinë “Për mbrojtjen sociale me vendet pritëse të emigranteve”.
- Fushatë sensibilizuese mbi njohjen e ligjit “Per barazinë gjinore në shoqëri”.
- Përkthimi dhe botimi i ligjit “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
- Trajnime mbi njohjen me ligjin “Per barazinë gjinore në shoqëri”.
- Ndjekja e zbatimit të VKM-së “Për rritjen e përfitimeve”.
- Rishikimi i bazës ligjore të programeve të nxitjes së punësimit në përputhje me legjislacionin evropian.
- Përmirësimi i kushteve të jetesës sipas prioriteteve të komunitetit Rom.
- Projekt ligji i ri “Për nxitjen e Punësimit” në përputhje me strategjinë evropiane të punësimit.
- Fillimi dhe vazhdimi i procedurave të diskutimit, shkëmbimit të informacionit në kuadrin e marrëveshjeve me Italinë, Greqinë.
- Studim për legjislacionin shqiptar të sigurimeve shoqërore në raport me rregulloren 1408/71 KEE të sigurimeve shoqërore.
- Projekt ligji “Për Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve”.
- Projekt ligji “Per sigurinë dhe shëndetin në pune”.
- Nënshkrimi i marrëveshjeve mes Televizionit Publik Shqiptar dhe kanaleve televizive kombëtare të vendeve pritëse të emigranteve për transmetimin e një fushate mediatike informuese në lidhje me fenomenet e emigracionit.

Aneks 3 Investimet publike

Programi Buxhetit	Emërtimi i Projektit	Buxheti Vjetor 2008 (miliona lekë)
Tregu i Punës	Ndërtimi i Qendrës së Formimit Profesional Elbasan (Kosto totale e projektit është 291 milion leke)	51
Tregu i Punës	Ndërtimi i Qendrës së Formimit Profesional Fier (Kosto totale e projektit është 228 milion lekë)	15
Tregu i Punës	Rikonstruksion i Qendrës së Formimit Profesional Durrës (Kosto totale e projektit është 41 milion lekë)	27
Tregu i Punës	Rikonstruksion i Qendrës së Formimit Profesional Gjirokastër (Kosto totale e projektit është 37 milion leke)	15
Tregu i Punes	Kosto lokale.TVSH dhe detyrime doganore	15
Tregu i Punës	Investime nga të ardhurat	5
Mbrojtja Sociale	Rikonstruksion i Qendrës së Rehabilitimit të të Verbërve (Kosto Totale e projektit është 387 milion lekë)	60
Mbrojtja Sociale	Kosto lokale .TVSH dhe taksë doganore	17
Planifikim, Menaxhim	Rikonstruksion i Godinës së MPÇSSHB (Kosto totale e projektit është 63 milion lekë)	33

Aneks 4 Projekte të ndihmës së huaj

Emri i Projektit	Donatori	Kosto Totale	Data e mbarimit
MBROJTIA SOCIALE			
TRAP- Trafikimi i personave për qëllim shfrytëzimi për punë	Qeveria Italiane në kuadër të programit CARDS	Parashikuar 690.000 euro për të gjitha vendet e rajonit	12 muaj mbas e nënshkrimit të marrëveshjes ¹
SISP - Mbështetje për Institucionet e mbrojtjes sociale	Komisioni Evropian, Këshilli i Europës	2 milion euro për të gjitha vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor	2010
Bashkëpunimi për zhvillimin e shërbimeve sociale dhe politikave të shëndetit publik	ERDF/CARDS/Rajonal	300.000 euro totali, për Shqipërinë janë përcaktuar 10.000 Euro	1 vit mbas nënshkrimit të marrëveshjes ²
TREGU I PUNËS			
Mbështetje për reformën në fushën e AFP (Faza e tretë)	Bashkimi Evropian (BE)	1.3 milion Euro	Dhjetor 2009
Binjakëzimi-Ngritja dhe fuqizimi i kapacitetit nstitucional të Agjencisë Kombëtare të Arsimit dhe Formimit Profesional	Bashkimi Evropian (BE)	900.000 Euro	Korrik 2008
“Shërbime Punësimi Efiçente në Shqipëri”	SIDA	300.000 Euro	Qershor 2008
“Asistencë për forcimin e sistemit të punësimit dhe formimit profesional në Sh.K.P”	Qeveria Italiane	600.000 Euro	Qershor 2009
Mundësi punësimi dhe formimi profesional dhe masa politikash migratore për parandalimin dhe reduktimin e trafikimit të grave ne Shqipëri, Moldavi dhe UkrainëILO/Migrant (Faza e dytë)	Qeveria e Irlandës	700,000 Euro	Mars 2008
MIGRACIONI			
Nxitja e zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Migracionin në Shqipëri	Bashkimi Evropian (BE)	Financimi CARDS 2004	Shkurt 2009
Mirëerdhet Përsëri: Riintegrimi i Emigrantëve” - ĔARM, AENEAS 2005	Komisioni Evropian dhe CARITAS-i Italian, Romë	1.5 milion Euro	1 Janar 2009
“Ngritja e mekanizmave për zbatimin e qëndrueshëm dhe efektiv të marreveshjeve të Ripranimit, ndërmjet Shqipërisë, BE dhe vendeve të treta të interesuara“AENEAS 2004	Komisioni Evropian & Qeveria Greke	1.818,460 Euro. Financimi 80% BE, 20% Ministria e Brendshme Greke	Prill 2008

Aneks 5 Masat në kuadër të luftës kundër korrupsionit

Tregu i Punës

- Përmirësimi dhe lehtësimi i procedurave që aplikohen për licensimin e subjekteve private si agjensi private punësimi.
- Përmirësimi dhe lehtësimi i procedurave që aplikohen për licensimin e subjekteve që ofrojnë formim profesional.
- Rritja e transparencës së përdorimit të fondeve të programeve të nxitjes së punësimit, nëpërmjet monitorimit të tyre me ekspertë të jashtëm (jo të huaj)

Mbrojtja Sociale

- Identifikimi i numrit të familjeve të varfra mbi bazën e nivelit të varfërisë absolute nën 2 \$ në ditë për person dhe hartës së varfërisë.
- Mbulimi i nevojave të familjeve të varfra me fonde në përputhje me strukturën e familjes.
- Rritja e transparencës në shpërndarjen e fondeve të NE, nëpërmjet aplikimit të punëve në komunitet.
- Rritja e numrit dhe cilësisë së inspektimit për zbatimin e standarteve të shërbimeve sociale si dhe auditimin e fondeve buxhetore.

Inspektimi në Punë

- Konsolidimi i ISHP-së nëpërmjet përsosjes së strukturave dhe përafrimit të legjislacionit me vendet e BE-së.
- Ngritja e njësisë së auditimit
- Kontrolli i vazhdueshëm i dokumentacionit teknik të inspektorëve të punës, evidentimi i mangësive në ushtrimin e detyrës si dhe evidentimi i rasteve të vendosjes së sanksioneve të ndryshme, për të njëjtat shkelje të legjislacionit të punës
- Vlerësimi në periudha periodike nga drejtuesit rajonalë në lidhje me realizimin e objektivave individuale të inspektorëve të punës, zbatimin nga ana e tyre të legjislacionit të punës
- Adoptimi i një metode të re, i vlerësimit të arritjeve individuale nëpërmjet vlerësimit periodik që Drejtorët Rajonalë duhet ti bëjnë punës së inspektorëve